MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË LIBRAZHD

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Librazhd me objekt: "Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik financiar" dhe dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 131, datë 15.9.2012.
Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 573/2 , datë 15.9.2012 , dërguar **z. Shefki ÇOTA,** Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Menaxheri i njësisë së qeverisjes vendore për inventarizimet dhe menaxhimin e aktiveve të marrë masa për ta dokumentuar këtë proces duke nxjerrë: urdhër për ngritjen e komisionit të vlerësimit dhe asgjësimit, listën e aktiveve të identifikuara për vlerësim, procesverbalin e asgjësimit, relacionin për objektet e asgjësuara, fletëdaljen, sipas "Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

Vazhdimisht

2. Të merren masa që komisioni i vlerësimit të ofertave, të emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor sipas VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" kreu V, pika 1, germa ç, pika 2 germa ç.

Vazhdimisht

3. Dokumentet që argumentojnë sasinë, përcaktimin e çmimit të zërave të preventivit për përcaktimin e kufirit monetar duhet të jenë pjesë e dosjes së prokurimit sipas përcaktimit të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" kreu II, pika 2, germa c, ç dhe ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 15, 22.

Vazhdimisht

4. Dokumentet standarde të tenderit të hartuara dhe firmosur nga njësia e prokurimit duhet të jenë pjesë e dosjes së tenderit dhe Titullari i autoritetit kontraktor duhet ti miratojë ato mbas hartimit të tyre nga njësia e prokurimit sipas VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", kreut V, pika 2, germa a, b.

Vazhdimisht

5. Specialistët në zbatim, drejtuesit teknikë dhe administratorët e operatorëve konkurrues duhet të jenë të kontraktuar, të jenë në listë pagesat dhe t`i referohen pagës referuese mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore, si dhe të tatimit mbi të ardhurat personale për personelin drejtues e tekniko-ekonomik, sipas nomenklaturës së veprimtarive ekonomike dhe të kërkesave të vendit të punës për kualifikim, sipas klasifikimit në vendin ku ushtrohet veprimtaria e biznesit bazuar në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006,"Për prokurimin publik", neni 45, pika 2/d, VKM nr. 285, datë 4.5.2007,"Për caktimin e pagës referuese mujore për efekt të llogaritjes së sigurimeve shoqërore" dhe UMF nr. 10, datë 21.6.2007, pika 4/v.

Vazhdimisht

6. Njësia e prokurimit në kriteret e veçanta të kualifikimit duhet të vendosë kritere kohore për periudha sa më të afërta me datën e zhvillimit të tenderit të cilat duhet te vërtetohen përmes dokumenteve të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës.

Vazhdimisht

7. Në aktmarrëveshjen e bashkëpunimit të operatorëve ofertues kur përcaktohet % e punimeve ajo duhet të shoqërohet me zërat konkretë të punimeve të preventivit që do të

kryejë secili pjesëmarrës sipas VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” Kreu VII, pika 2, germa a, b.

Vazhdimisht

8. Të merren masa që për orë shtesë jashtë kohës normale të punës paraprakisht duhet dokumentacion urdhërues dhe dokumentues për punët që kryhen në përputhje me VKM nr. 591, datë 23.7.2010 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore” pika 1, germa “c”.

Vazhdimisht

9. Të merren masa që zhbllokimi i garancisë të objekteve të kryhet në përfundim të periudhës së garancisë, pasi investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve të bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës duke mbajtur dokumentacionin përkatës si përcaktohet në udhëzim nr. 1, datë 22.2.2005 “Për disa shtesa në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit".

Vazhdimisht

10. Të merren masa për të gjendur një zgjidhje dhe të lirohen fondet e bllokuara nga gjendje e lartë e disa materialeve stok, shtypshkrime të llojeve të ndryshme të dala nga qarkullimi, në shumën 182,400 lekë.

Menjëherë

11. Në funksion të menaxhimit financiar dhe kontrollit, titullari i njësisë publike (Bashkisë), të hartojë politikat, të miratojë dhe monitorojë objektivat e njësisë publike që ai drejton, planet strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave. Të ngrihet grupi i menaxhimit strategjik të njësisë publike, i cili të përbehet nga menaxheri kryesor i njësisë publike dhe të kryesohet nga ai vete sipas ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Menjëherë

12. Nga bashkia të miratohet një sistem i rregullave specifike e të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, bazuar në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF nr. 54, datë 15.7.2010 “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Pika B.

Menjëherë

13. Të miratohen akte të brendshme administrative për të siguruar ngritjen dhe zbatimin e rregullave për kontrollin e brendshëm bazuar në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Manualin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Menjëherë

14. Nëpunësi autorizues duhet të raportojë tek titullari i njësisë publike për monitorimin, përditësimin, zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej tij, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës.

Vazhdimisht

15. Të merren masa për hartimin propozimin dhe raportimin për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtrimit e të parregullsive dhe të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave, ose risqe, të cilat nuk janë adresuar nga njësia, masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet e menaxhimit të njësisë.

Vazhdimisht

16. Të hartohen nga bashkia dhe të depozitohen te Ministri i Financave vetëvlerësimi, deklarata vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike duke respektuar afatet sipas ligjit nr. 10296, datë 8.7.2011,“Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, nenit 18.

Menjëherë

17. Taksa mbi biznesin e vogël, taksa e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve, taksa për zënie vendi në treg të parashikohen bazuar mbi planifikimet e viteve të mëparshme dhe studime të mirëfillta për rritjen demografike të juridiksionit të kësaj bashkie.

Vazhdimisht

18. Për parashikimin dhe llogaritjen e saktë të ardhurave nga tarifa e pastrimit, bashkia për çdo vit të marrë për bazë evidencën e gjendjes civile për familjet që janë në fakt.

Vazhdimisht

19. Sektori i financës duhet të pasqyrojë në kontabilitet në fund të vitit listat e debitorëve të dërguara nga zyra e taksave për detyrimet fiskale të vitit të mbyllur.

Vazhdimisht

20. Në dosjet për lejet e shfrytëzimit duhet të depozitohet situacioni përfundimtar i objektit i miratuar nga dega e tatim taksave, me qëllim të rivlerësimit të vlerës dhe llogaritjes së shtesës për taksat e ndikimit në infrastrukturë, sipas kërkesave të ligjit nr. 8402, date 17.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim".

Vazhdimisht

21**.** Të merren masa që pozicioni i përgjegjësit të sektorit të kategorizohet në kategorinë III-b në zbatimi të VKM nr. 598, datë 27.4.2009 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 1619, datë 2.7.2008 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore", lidhja 4.

Menjëherë

A. <u>MASA PËR SHPËRBLIM DËMI</u>

Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **227,683 lekë** duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit si më poshtë:

1. Për 9 punonjësit nga 8,037 lekë secilit, [redacted], pasi me vendimet e Këshillit Bashkiak të vitit 2010 dhe vitit 2011, respektivisht nr. 6, datë 29.01.2010 dhe nr. 12, datë 15.7.2011 "Për miratimin e kategorizimin e nivelit të pagave të aparatit të bashkisë dhe institucioneve në varësi të saj", përgjegjësit e sektorit janë kategorizuar në klasën III-a e cila nuk ekziston si kategori në vendimet respektive të Këshillit të Ministrave për pagat në organet e pushtetit vendor për përgjegjësit e sektorëve, të cilët duhet të kategorizohen në kategorinë III-b.

Për sa më lart, shuma **72.333 lekë** duhet të zhdëmtohet nga punonjësit, duke e kthyer shumën e mësipërme në buxhetin e Bashkisë Librazhd.

Menjëherë

2. Shpenzimi prej 103.350 lekë për aktivitetin me rastin e daljes në pension të 2 personave dhe festimin e vitit të ri 2010, përballuar nga artikulli 602, kur në zbatim të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", këto veprimtari duhet të përballohen nga fondi i veçantë, por pika 9 e vendimit të mësipërm ka vendosur, që "Përjashtimisht, për vitin 2010 fondi i veçantë nuk përdoret për shpërblimin e punonjësve për rezultate të mira në punë dhe veprimtari social-kulturore".

Për sa më lart, shuma **103,350 lekë** duhet të zhdëmtohet nga pjesëmarrësit, duke e kthyer shumën e mësipërme në buxhetin e Bashkisë Librazhd.

Menjëherë

3. Për punonjësit [redacted], nga 4,500 lekë secili, përfituar shpërblim me rastin e 8 marsit në zbatim të urdhrit nr. 14, datë 1.3.2010.

Për sa më lart, shuma **45,000 lekë** duhet të zhdëmtohet nga punonjësit, duke e kthyer shumën e mësipërme në buxhetin e Bashkisë Librazhd.

Menjëherë

4. Për z. [redacted] për udhëtim e dieta përfituar **5,000 lekë** më shumë për vitin 2010 të cilën duhet t'i kthejë në buxhetin e Bashkisë Librazhd.

Për sa më lart, shuma 5,000 lekë duhet të zhdëmtohet nga përfituesi, duke e kthyer shumën e mësipërme në buxhetin e Bashkisë Librazhd.

Menjëherë

5. Për mos mbajte në burim tatimi mbi të ardhurat shuma **2,000 lekë** e siguruara nga qiraja e dy ambienteve të përdorura për zgjedhjet për pushtetin vendor të vitit 2011.
Për sa më lart, shuma 2,000 lekë duhet të zhdëmtohet nga qiramarrësi, duke e kthyer shumën e mësipërme në buxhetin e Bashkisë Librazhd

Menjëherë

C. KALLËZIM PENAL

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit të bëhet Kallëzim Penal, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me motivacionin:
Për: Fillimin e procedimit penal ***"shpërdorim detyre",*** parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
Në ngarkim të:

1. Për z. [redacted] ish Kryetari i Bashkisë Librazhd.
2. Për **z.** [redacted] ish Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës i Bashkisë Librazhd.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Bexhet Zeqiri, Pullumb Beqiraj, Vasillaq Peci dhe Qemal Meta . Më tej u shqyrtua nga Kryeauditues i Departamentit, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT